## Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrimit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

## Aktivitetet përgjatë muajit Dhjetor, 2022

### Pjesëmarrje aktive në Konferencën Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit (IACC) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës







**05-14.12.2022:** Ministri i Drejtësisë në ushtrim të kompetencave të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit kryesoi delegacionin e Qeverisë Shqiptare në Konferencën Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit (IACC), "Çrrënjosja e korrupsionit dhe mbrojtja e vlerave demokratike", të zhvilluar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Konferenca ndërkombëtare kundër korrupsionit bëri bashkë zërin e përfaqësuesve të lartë politikë dhe ekzekutive të vendeve me qëllim promovimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimeve në nivel ndërkombëtar për t'iu përgjigjur sfidave gjithnjë e më të sofistikuara të luftës kundër korrupsionit. Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja dhe Zëvendësministri znj. Adea Pirdeni zhvilluan takime intensive bashkëpunimi me partnerë dhe homologë, për çështje që i takojnë luftës kundër korrupsionit, konsolidimit të shtetit të së drejtës dhe avancimin e rezultateve të reformës në drejtësi në kontekstin kombëtar. Partneriteti midis dy vendeve, Shqipëri-SHBA, në drejtim të efektivitetit të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në luftën ndaj krimit, rritja e standardeve të sigurisë në sistemin penitenciar, asistenca në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe rritjes së eficencës në sistemin e drejtësisë, ishin disa nga çështjet kryesore të trajtuar gjatë takimeve të zhvilluara me zyrtarë të lartë të Departamentit të Shtetit dhe organizatave ndërkombëtare me qendër në Washington. Konferenca Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit është themeluar në vitin 1983 dhe zhvillohet çdo dy vjet duke pritur deri në 2000 pjesëmarrës nga mbi 140 vende të botës, dhe bashkuar në këtë forum ndërkombëtar aktorë të rëndësishëm të sektorit publik, privat, dhe shoqërisë civile.

**Më shumë informacion mund të gjeni në link:** https://www.facebook.com/drejtesia.gov.al/posts/702995737847896

### Fushata "Java e Integritetit 4": Promovimi i integritetit për individët dhe organizatat, si instrument antikorrupsion, prioritet i përbashkët publik-privat










**1-10.12.2022:** Muaji Dhjetor i njësuar si muaji i luftës kundër korrupsionit bëri bashkë partnerë dhe bashkëpunëtorë të sektorit publik, privat, organizata jo-qeveritare, përfaqësi dhe organizata diplomatike të huaja, studentë dhe të rinj, qytetarë vigjilentë dhe të interesuar ndaj zhvillimeve të vendit, në edicionin e 4-t të fushatës "Java e Integritetit". Ministria e Drejtësisë/Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit vijoi bashkëpunimin e tij aktiv në zhvillimin dhe pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë politikë dhe sidomos të drejtuesve ekzekutivë dhe teknikë të fushës në disa prej aktiviteteve të zhvilluara. Konferenca me temë "Promovimi i Integritetit: Individi, Organizata dhe Përtej", bëri bashkë aktorë dhe faktorë të rëndësishëm, të angazhuar në luftën kundër korrupsionit, me fokus promovimin e integritetit dhe forcimin e transparencës. Nxitja e një dialogu të hapur midis drejtuesve dhe ekspertëve nga sektori privat dhe publik, organizatave dhe akademikëve, për t'iu përgjigjur çështjeve aktuale, si rritja e ndërgjegjësimit dhe promovimi i sjelljes etike, zgjoi interes dhe vëmendje. Zëvendësministri i Drejtësisë z.Klajd Karameta dhe Drejtori i Njësisë Operacionale Antikorrupsion z.Gjergj Prabibaj, adresuan disa nga çështjet kryesore lidhur me integritetin dhe transparencën e institucioneve publike në dy panele të dedikuara për këtë qëllim, ku u evidentua përparësia e integritetit institucional, etikës së biznesit dhe përgjegjësisë individuale në kohë sfidash. Ekspertët kundër korrupsionit pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit morrën pjesë në panelet e tjera për diskutimin e politikave të fushës, gjithashtu.

**Më shumë informacion mund të gjeni në link:** https://www.facebook.com/ICCAlbania/posts/6087185087971742

### Ballkani Perëndimor rikonfirmon Udhërrëfyesin Rajonal: Antikorrupsioni dhe Kontrolli i Financave të Paligjshme








**14.11.2022:** Ballkani Perëndimor rikonfirmon vullnetin politik dhe ekzekutiv të lartë për të vijuar me bashkëpunimin rajonal në fushën e luftës kundër korrupsionit dhe të financave të paligjshme. 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëri, Bosnje&Hercegovinë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Kosovë dhe Serbi u mblodhën bashkë në Shkup, në punimet e konferencës rajonale të organizuar nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut, për të shprehur dakordësinë e tyre për të vijuar me këtë projekt bashkëpunimi të iniciuar prej më shumë se një viti me parë nga UNCAC/UNODC dhe me asistencën në zbatim të organizatës rajonale kundër korrupsionit, RAI. Të gjitha vendet pjesëmarrëse dhanë miratimin e tyre për të vijuar me zbatimin e angazhimeve të përfshira në Udhëzuesin: Antikorrupsioni dhe Financimi i Paligjshëm, për vitet e ardhshme 2023-2024 në çështje si transparenca e prokurimeve publike, deklarimi i pasurive (online) dhe konflikti i interesave, dhe forcimi i kapaciteteve dhe rritja e bashkëpunimit midis organeve ligjzbatuese dhe të ndëshkimit (polici-prokurori-njësitë e pastrimit të parave). Rrjeti i Prokurorive, GLoBE ka një hapësirë të posaçme veprimi në këtë dokument angazhimi. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Agjencia e Prokurorimit Publik, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, SPAK, Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit janë angazhuar plotësisht në mbështetjen e bashkë-hartimit dhe zbatimit të kësaj nisme.

**Më shumë informacion mund të gjeni në link:** https://www.facebook.com/raiseeorg/posts/533067942193696

### Grupi Tematik Antikorrupsion teknik dakordëson përmbajtjen e raportit të monitorimit korrik - shtator 2022 për zbatimin e Planit të Veprimit Antikorrupsion








**09.12.2022:** Grupi Tematik Antikorrupsion në nivel teknik, i përbërë nga përfaqësues të të gjithë institucioneve të përfshira në zbatimin e Planit të Veprimit Antikorrupsion, zhvilloi takimin teknik të punës, në të cilin dakordësoi përmbajtjen e raportit të monitorimit korrik - shtator 2022. Ky raport jep një informacion të plotë dhe vlerësues mbi ecurinë e 18 objektivave specifike për të tre qasjet e politikave në luftën kundër korrupsionit, parandalim-ndëshkim-ndërgjegjësim. Raporti përmban një analizë të të dhënave të institucioneve përgjegjëse mbi zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara, për periudhën raportuese. Në këtë 3-mujor të 3-të të vitit 2022, zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit është në masën 46.2 %. Përkatësisht sipas qasjeve, progresi është: parandalimi 77.04%; ndëshkimi 32.5% dhe ndërgjegjësimi 29.16%. Në këtë periudhë raportuese, kanë qenë për zbatim 57 masa e 102 aktivitete, nga të cilat 25 masa/51 aktivitete janë realizuar plotësisht, 16 masa/12 aktivitete janë realizuar pjesërisht dhe 16 masa/38 aktivitete nuk janë realizuar. Për t'u evidentuar janë trendi rritës dhe konsolidimi i rezultateve të qasjes ndëshkuese të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore si dhe një vlerësim shumë i mirë mbi objektivat që lidhen me rritjen e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimin e aksesit të qytetarëve në informacion, përdorimin sistematik të mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion, forcimin e integritetit të nëpunësve publikë, analizimin e prirjeve të korrupsionit, efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimit të statistikave si dhe aktivitetet ndërgjegjësuese dhe edukuese të publikut mbi pasojat e korrupsionit.

**Draft raporti i publikuar dhe raporti i konsultimit mund të aksesohen në link:** https://drejtesia.gov.al/viti-2022-2/

### Këshilltarët politikë të ministrave ndërgjegjësohen mbi rregullat e etikës dhe integritetit







**12-14.12.2022:** Ministria e Drejtësisë organizoi takimin-trajnim për stafet politike ministrore, për çështje të etikës dhe integritetit dhe zbatimin e rregullave të konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrës publike. Me mbështetjen e zyrës së Këshillit ët Evropës në Tiranë, në kuadrër të projektit "Aksioni Kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri (*AEC-Albania*)", u zhvillua trajnimi për të gjithë këshilltarët politikë të ministrave, për tre ditë. Tematikë e trajnimit dhe diskutimit ishin çështje për njohjen dhe zbatimin praktik të kërkesave ligjore në fuqi për etikën, parandalimin e konfliktit të interesave, integritetit, pas-punësimin dhe deklarimin e pamundësisë ligjore për të marrë pjesë në procese dhe procedura. Tematikat e trajtuara janë një domosdoshmëri për përmirësimin e zbatimit të kornizës ligjore dhe institucionale për të parandaluar korrupsionin në autoritetet tona publike, nga funksionarët e lartë politikë ekzekutive. Rritja e ndërgjegjësimit, shpërndarja e njohurive dhe edukimi profesional i këshilltarëve politikë për zbatimin praktik të kërkesave ligjore ekzistuese në fushën e etikës, parandalimit të konfliktit të interesave dhe integritetit, është një faktor vendimtar për qeverisjen e mirë dhe respektimin e ligjit. Ekspertët panelistë, ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë dhe këshilltarët politikë, diskutuan dhe ndanë raste dhe shembuj konkretë për parimet dhe rregullat e përgjithshme të legjislacionit tonë mbi standardet dhe praktikat ndërkombëtare, duke përfshirë rekomandimet dhe udhëzimet e Këshillit të Evropës për etikën dhe integritetin e zyrtarëve publikë.

**Më shumë informacion mund të gjeni në link:** https://www.facebook.com/CoEinTirana/posts/849726543046201

### Partneriteti për Qeverisje të Hapur: Ministria e Drejtësisë konfirmon angazhimin e përfshirjes në planin e veprimit, 2022-2024





**19.12.2022:** Ministria e Drejtësisë fillon procesin e bashkë-bërjes së planit të ri të veprimit, për Partneritet për Qeverisje të Hapur (OGP), 2022-2024, për angazhimet e veprimtarisë së saj, antikorrupsioni dhe drejtësia. Procesi i bashkë-bërjes me organizatat e shoqërisë civile është një eksperiencë e vlerësuar nga OGP qendrore për Ministrinë e Drejtësisë, e kryer sipas parimeve të OGP, dhe që rifillon tashmë sërish për dokumentin e ri, 2022-2024. Hapi i parë i hartimit të planit të veprimit ishte hartimi i një pyetësori-sondazh me propozime për mendim dhe kërkim bashkëpunimi, gjithashtu. Pyetësori-sondazh u shpërnda në një grup organizatash aktive në fushën e qeverisjes së mirë, antikorrupsionit dhe drejtësisë, dhe mund të gjendet i publikuar lehtësisht në faqet e internetit të drejtesia.gov.al dhe ogp.gov.al, dhe me një adresë kontakti për dërgim kontributi. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut për mekanizmat e luftës kundër korrupsionit dhe gjithashtu të aksesit në drejtësi janë propozime konkrete për angazhime për t'u përfshirë nga Ministria e Drejtësisë, për të cilat pritet dakordësim dhe bashkëpunim nga organizatat e shoqërisë civile.Organizatat janë të mirëpritura në rolin e tyre pjesëmarrës si propozues, zbatues-ndërgjegjësues dhe financues. Kjo fazë e procesit do të shoqërohet nga takime konsultimi të dedikuara deri në datë 17 janar 2023.

**Mund të aksesoni pyetësorin për plotësim në link:** https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/12/Pyetesor-per-bashke-berjen-e-PV-OGP-2022-2024.pdf